VENDIM
Nr. 893, datë 27.12.2022

PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA", NË KUADËR TË LËVIZJES OLIMPIKE SHQIPTARE TË KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR (KOKSH)

(ndryshuar me VKM nr. 705, datë 6.12.2023; me VKM nr. 632, datë 10.10.2024)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të neneve 13 dhe 15, të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin, në masën 750 000 000 (shtatëqind e pesëdhjetë milionë) lekë, të projektit "Ekipet sportive në shkolla", në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), të ndarë:

a) 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2022;

b) 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2023;

c) 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2024.

2. Fondi i përcaktuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, transferohet në llogarinë e KOKSH-it, në bankën e nivelit të dytë dhe përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2022 *dhe buxheti i miratuar për vitin 2023 si dhe buxheti i miratuar për vitin 2024* për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, përkatësisht, në llogarinë ekonomike 604 "Transferta të brendshme", në programin buxhetor 08140 "Zhvillimi i sportit".

3. KOKSH-i, brenda muajit janar 2023 *dhe brenda muajit shkurt 2024, si dhe brenda muajit shkurt 2025, përkatësisht për financimet sipas shkronjave "a", "b" dhe "c" të pikës 1, të këtij vendimi*, të paraqesë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit projektin e detajuar dhe të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e tij, duke identifikuar të gjitha aktivitetet/produktet dhe infrastrukturën e parashikuar në projekt, kohëzgjatjen e zbatimit të projektit, federatat dhe organizmat e tjerë përfitues nga projekti. Projekti duhet të jetë i kostuar me të gjithë produktet/zërat analitikë të shpenzimeve, në përputhje me klasifikimin ekonomik buxhetor të tyre.

4. KOKSH-i raporton periodikisht mbi bazë katërmujore në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për ecurinë e aktiviteteve/produkteve dhe realizimin financiar të projektit. *Brenda muajit shkurt 2025 të depozitohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit raporti vjetor i veprimtarisë së projektit "Ekipet sportive në shkolla", përfshirë raportimin financiar.*

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit cakton një grup pune për mbikëqyrjen e realizimit të mbështetjes financiare të KOKSH-it. Përbërja dhe detyrat e grupit të punës përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama